

Të shtëna me armë zjarri në drejtim të një personi në Mitrovicë, lëndohet ai dhe një femër



11/07/2024 10:19



Policia e Kosovës ka njoftuar se mbrëmë në Mitrovicë një person ka pësuar lëndime trupore pasi dyshohet se dy persona të tjerë për shkak të një mosmarrëveshje të mëhershme, kanë shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës dhe pastaj të dyshuarit me veturë janë larguar në drejtim të panjohur.

Sipas njoftimit të Policisë thuhet se viktimja është dërguar për tretman mjekësor dhe sipas mjekëve kompetent gjendja e tij është stabile, ndërsa lëndime të lehta ka pësuar edhe viktimja femër të cilës po ashtu i është ofruar tretman mjekësor.


“Njësitët policore në vendin e ngjarjes kanë sekuestruar veturën e viktimës për ekzaminim, ndërkohë që lidhur me rastin është informuar dhe konsultuar edhe prokurori. Rasti duke u hetuar”, thuhet në raportin 24-orësh. /Lajmi.net/

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LajmiMedia



Artikuj të ngjashëm



July 11, 2024

Tensione në protestën e opozitës në Tiranë, qëllohet me koktej molotov...



July 11, 2024

Kica-Xhelili flet për ligjin për KPM-në: Po synohet të ushtrohet kontroll...



July 11, 2024

Kurti mirëpret një delegacion nga Bosnja dhe Hercegovina, i dhurojnë simbolin...



July 11, 2024

Kurti mori pjesë në ngjarjen e organizuar me rastin e shënimit...



July 11, 2024

Gorani për vizitën e Osmanit: Amerikanët e thirren me i tregu...



July 11, 2024

S'je t'i kërkush me ma ndal bukën e gojës, nuk e...